BREAKING NEWS
"PJESA TJETËR E EUROPËS NA BRAKTISI", ZJARRFIKËSI ITALIAN QË RREZIKOI JETËN GJATË TI

AKTUALITET

Zbardhet plagosja e 42-vjeçarit në Durrës, fqinji i maskuar hyri në banesë dhe plagosi pronarin, policia në kërkim të autorit

SHKRUAR NGA ELVIS MYRTA
12 SHKURT 2020

Facebook WhatsApp Twitter Email



Policia e Durrësit ka zbardhur ngjarjen e ndodhur mbrëmjen e së hënës në qytetin bregdetar, ku mbeti i plagosur 42-vjeçari, Rexhep Terziu. Sipas uniformave blu 42-vjeçari ka rënë pre e një tentative grabitjeje dhe pasi ka bërë rezistencë është plagosur nga autori. Burime zyrtare nga uniformat blu bënë me dije se Astrit Thaçi, 27 vjeç me precedent penal, është autori i autori i grabitjes që përfundoi me plagosjen e 42-vjeçarit Rexhep Terziu në banesën e tij në lagjen 13 të qytetit të Durrësit. I riu që sipas burimeve sapo kishte dalë nga burgu është po ashtu i dyshuar edhe për grabitjen e pikës së kredive Kredo.al, ngjarje e ndodhur të shtunën në qytetin bregdetar. Ai u identifikua nga policia mbi bazë të provave që ka lënë në vendngjarje dhe veshjes që ai përdori. Rreth 100 metra larg banesës që ai tentoi të grabisë u sekuestrua edhe makina e 27-vjeçarit ku u gjet edhe një sasi lënde narkotike. Policia e Durrësit thotë se mbi këto prova e ka shpallur atë në kërkim dhe po punon për ta vënë në pranga. Tentativa e grabitjes që përfundoi me plagosje u shënua rreth orës 20: 30 në lagjen 13 ku banon edhe vetë autori. 27-vjeçari hyri i maskuar dhe i armatosur në banesën e familjes Terziu për të vjedhur, por pasi u zbulua nga kryefamiljari Rexhep Terziu, të cilin e qëlloi me pistoletë në këmbë. Ky i fundit ka thënë për grupin hetimor, se sapo ishte kthyer në shtëpi kur ka dëgjuar zhurmë. Ai është konfrontuar me hajdutin që për ti shpëtuar kapjes e qëlloi. 42-vjeçari mori ndihmën e parë në Spitalin e Durrësit dhe mësohet se është jashtë rrezikut për jetën. Policia e Durrësit ka dyshime të forta se 27-vjeçari Thaçi, i dënuar për vjedhje më parë edhe në Itali e Shqipëri është edhe autor i grabitjes së pikës së kredive Kredo.al, ndodhur disa ditë më parë në qytetin e Durrësit. Për këtë ekspertët po analizojnë gjurmët e marra në të dy vendngjarjet, ndërkohë që blutë vijojnë kërkimet për ta vënë në pranga. Në polici Terziu ka thënë se sapo ishte kthyer në banesën e tij nga puna ku kishte dëgjuar një zhurmë të lehtë. Sipas tij në momentin që kishte dalë jashtë, ai ka parë grabitësin dhe e ka kapur tek rruga, ku edhe është përleshur me të. Në këtë moment grabitësi ka nxjerrë pistoletën dhe e ka qëlluar në këmbë. Më pas hajduti është larguar me vrap nga vendngjarja.

Hetimet

27-vjeçari, i shpallur në kërkim sapo ka dalë nga burgu dyshohet se është autori i dy grabitjeve të ndodhura në harkun e tre ditëve në qytetin e Durrësit. Policia ka identifikuar Astrit Thaçin si autor të grabitjes me pasojë plagosjen e një 42 vjeçari në shtëpinë e tij dhe një pikë kredish në qytetin bregdetar. Në vijim të hetimeve është identifikuar dhe shpallur në kërkim autori i dyshuar i ngjarjes, Astrit Thaçi, 27 vjeç, me precedent penal në fushën e narkotikëve. Efektivët e policisë, menjëherë pas ngjarjes së ndodhur në lagjen nr. 13, Plazh, ku një person i maskuar dhe me armë zjarri pistoletë, në tentativë për të vjedhur në banesën e Terziut, plagosi në këmbë me armë zjarri të zotin e banesës dhe u largua me shpejtësi, menjëherë organizuan punën për identifikimin dhe kapjen e autorit. Menjëherë u ngrit një grup i posaçëm hetimor, nën drejtimin e Prokurorisë së Durrësit, si dhe u ngritën pika kontrolli të shumta dhe u zhvilluan kontrolle në banesa e objekte të ndryshme. Falë veprimeve të shpejta nga grupi hetimor u bë e mundur që brenda pak orëve të zbardhej ngjarja dhe të identifikohej autori i dyshuar i kësaj ngjarjeje. Në përfundim të veprimeve u bë shpallja në kërkim e Astrit Thaçi, 27 vjeç, banues në lagjen nr. 13, Durrës dhe vijon puna për kapjen e tij. Ndaj të dyshuarit hetimet janë në vijim, ndërkohë që materialet i kaluan Prokurorisë së Durrësit, për veprime të mëtejshme. Sakaq mësohet se rreth 150 metra larg shtëpisë së Terziut është gjetur makina e Thaçit dhe brenda saj disa doza kanabis sativa. Në cilësinë e provës materiale u sekuestrua automjeti që ka përdorur autori i dyshuar, një palë veshje dhe prova të tjera që shërbejnë për dokumentimin e ngjarjes. Plagosja ndodhi teksa i zoti i shtëpisë pikasi të dyshuarin duke e ndjekur, por në këto momente u plagos.

Mesazhe Promocionale

8 New Cars So Awesome It's Hard to Believe They Cost Under $20k
Hotels in Berlin Might Actually Surprise You

A-Class i ri.
Krijuar për Ju!

Gossip

Skenat e nxehta fusin në sherr “Bihterin” dhe “Elifin”, plas keq mes dy aktoreve

Aktoret Beren Saat dhe Tuba Buyukustun kanë pasur një përplasje m...

Opinione

ARTAN XH. DUKA PROF. AS. DR.
Humano-virusi i njollës blu!

NGA FIQIRI XIBRI
Hej njerëz COVID – 19 është një mashtrim i madh...

PIRRO PRIFTI
Kosova ka nevojë për një qeveri pro-amerikane



RAMAZAN SHERJA
Pasi të kemi mposhtur koronavirusin

LEXO OPINIONE TE TJERA

Mesazhe Promocionale

8 New Cars So Awesome It's Hard to Believe They Cost Under $20k
Hotels in Berlin Might Actually Surprise You

8 New Cars So Awesome It's Hard to Believe They Cost Under $20k
Hotels in Berlin Might Actually Surprise You

Taboola Feed

“Dy herë vetëkarantinim”, pedagogia e njohur zbulon masat emergjente që duhet të marrë Shqipëria për koronavirusin: Herën e parë u vetëizolova në Pekin për 12 ditë!
Pedagogia Haris Vongli ka bërë me dije se ajo është vetëkarantininuar dy herë gjatë kësaj periudhe ku virusi po përhapet me shpejtësi në të gjithë botën

Flat Prices in Tirana Might Actually Surprise You
Flats for Sale | Search Ads | Sponsored

The Cost of New SUVs May Surprise You
SUVs | Search Ads | Sponsored

London Apartments for Rent Might Surprise You
London Apartments | Search Ads | Sponsored

The Most Addictive Game of the Year 2019
Forge of Empires - Free Online Game | Sponsored

The Cost of Hair Transplant in Turkey Might Surprise You
Hair Transplant | Search Ads | Sponsored

“E kujt i pl*si se ç’thotë ai aman”, Manjani e lëshon gojën keq ndaj Ramës

Video e presidentit italian që u publikua gabimisht nga zyra e shtypit po bën xhiron e rrjetit, ja çfarë të vërtete ka treguar ai

London Apartment Price Might Surprise You
London Apartments | Search Ads | Sponsored

Më të lexuarat



“Një gjest dhe një sinjal i fuqishëm”, studiuesi i njohur italian i shkruan letër Edi Ramës



“Ishte me koronavirus dhe doli me sukses nga operacioni urgjent”, mnistrja Manastirlu jep njoftimin e rëndësishëm: Hapet sot spitali...



Lufta ndaj koronavirusit/ Modeli shqiptar, i martuar me miliarderen kineze jep lajmin e madh



Ishin kthyer në një tmerr për banorët, arrestohen dy të shpallurit në kërkim nga Kavaja



Dyshohej se ishin infektuar me koronavirus, dalin përgjigjet e analizave për dy vajzat nga Pogradeci



Itali bie numri i të vdekurve në 756, të shëruarit 646, të infektuar 3815 më shumë

Frenohet koronavirusi në Lombardi, bie numri i të infektuarve me 525, vdekjet bien me 126 viktima më pak

URGJENCA
INFEKTIVE

Djali i punonte në call center dhe ka temperaturë të lartë, konfirmohen dy raste të reja me koronavirus në Durrës

SotNews

Sot.com.al është një media online, që ka për qëllim informimin e paanshëm duke vënë profesionalizmin në plan të parë. Ky portal informativ është një alternativë e re që rreket të krijojë nje hapësirë sa më të lirë për gazetarinë e vërtetë. Përvoja e gjatë dhe nevoja për të shkuar sa më pranë të vërtetës, janë vijat mbi të cilat do të shkruajë media jonë.

Created by Mediadesk

AKTUALITET
POLITIKE
BOTA
RAJONI
EKONOMI
KULTURE
SHENDET
LIFESTYLE
KUZHINE
GOSSIP
SPORT
OPINIONE

English Version
Kontakto redaksinë
Merr njoftime nga SotNews

Na ndiq edhe në